

Serbia po vazhdon të sfidojë Kosovën në çdo aspekt. Një prej sfidave kryesore del të jetë ministri Aleksandër Jabllanoviç, i cili shtetit i referohet si Kosova e Metohia.

Ministri për Kthim dhe Komunitete, Aleksandër Jabllanoviç, ofendoi rëndë protestuesit e djeshëm në Gjakovë, pasi i quajti egërsira!

“Kjo është festë e shenjtë dhe e madhe. Egërsirat që i parandaluan serbët për të ardhur në shtëpitë e tyre të djegura, nuk do t'i shërbejnë askujt. Ne do të kërkojmë llogari nga ministri i Brendshëm për këtë që ndodhi”, ka thënë ai.

Përpos kësaj, Jabllanoviç, sa herë që po iu drejtohet medieve, Republikës së Kosovës i referohet si Kosovë e Metohi. Kjo deklaratë do të duhej të shihej si shkelje ligjore e kushtetuese dhe në këtë rast kërkohet ndërhyrja e qeverisë.

Vetëvendosje, që ka kundërshtuar hyrjen e listës serbe në kuvend dhe që ka përkrahur protestën në Gjakovë, thotë se veprimet e Jabllanoviçit janë një argument i qartë sesi Qeveria e Kosovës e ndan pushtetin me Serbinë.

Mosveprimi i Isa Mustafës në këtë rast, sipas Imer Mushkolajt, është argument i qartë se nuk duhet besuar në këtë Qeveri. /KTV/